

Zgjedhjet komunale në Mynih 2026

Vota jote vlen (është me rëndësi)

Me 8 mars ti zgjedh: **Prefektin e qytetit (OB)**,
këshillin bashkiak dhe këshillat komunal.

Kush mund të votoj?

Të gjithë ata/ato që kanë shtetësinë gjermane
apo shtetësinë e njërit nga shtetet e EU-
së, që janë 18 vjeç dhe kanë më së paku dy
muaj adresën kryesore të banimit (banorë
resident) në Mynih.

Kështu mund të votosh në Mynih:

Për Prefektin e qytetit ke një votë. Zgjedhë
Dominik Krause për një Mynih kosmopolit, të
bashkuar dhe solidar.

Për këshillin bashkiak ke 80 vota. Që të shkoj-
në të gjitha votat e tua për të gjelbërit, voto
lart listën Bündis 90/Die Grünen. Me këtë ti

përçon një sinjal të fort për një Mynih
miqësor ndaj klimës dhe drejtësi sociale.

Mundësi alternative gjatë votimit keni edhe
kumulimin e votave, dmth një kandidat mund
të marrë 3 votë (votohet 3 herë) ose sistemin
e përzier zgjedhor, dmth mund të votoni
edhe kandidatët e listave zgjedhore të
ndryshme. E njëjta vlen edhe për zgjedhjet
e këshillave komunal (Bezirksausschuss) -
„Parlamenti yt ndërkomunal“: ti ke po aq
vota, sikurse që gjenden në listën zgjedhore.

Materialin zgjedhor e merr të dërguar, pa
pasur nevojë që të parashtrosh një kërkesë.
Votimi me postë është i mundur-thjeshtë
parashtroshi kërkesën-pa pasur nevojë të
arsyetoni kërkesën.

Për sot. Për nesër. Për Mynihun.

i



Dominik Krause

Në vend të ecjes mbrapa
(Rollback) dhe stagnimit ne
dhe kandidati ynë për Prefekt
Dominik Krause: Mynihu
mundet më shumë.

Për më shumë në
programin tonë zgjedhor
në të gjitha gjuhët:

gruene-muenchen.de/kw2026/international



Sepse mundemi të bëjmë më shumë.



GRÜNE
MÜNCHEN



Kryetar bashkie për Mynih

Dominik Krause

Qyteti ynë është i fortë – por ai është nën një presion të fortë: qiratë e larta, rrugë dhe trena të stërmëshur, temperatura verore të larta dhe t'prekshme. Ne të Gjellbërit synojmë të bëjmë Mynihun fit për të nësërmen – të përballueshëm financiarisht, mobil dhe ambiental. Për këtë kemi nevojë për një fraksion të fortë të të gjellbërve në këshillin bashkiak dhe një Prefekt, i cili merr përsipër përgjegjësinë, në vend që të rrijë duarkryq.

Qëllimi ynë është i qartë: një qytet, në të cilin të gjithë të mund të jetojnë mirë – pa dallim nga të ardhurat financiare, nga mosha apo preardhja e qytetarëve. Një qytet që ofron mundësi dhe i trajton problemet.

Ne qëndrojmë për **guximin për të vepruar dhe prioritete** të qarta. Paraja publike duhet të investohet në arsim, banim publik dhe infrastruktur të pastë. Ne do të ju qëndrojmë personalisht qytetareve afër. Që Mynihu të mbetet një qytet i hapur dhe me zemër, ne të gjithë së bashku duhet që **me 8 mars 2026 të përcaktojmë kursin nga do të shkojmë.**

Për këtë arsye: të gjitha votat për të gjellbërit – për një Mynih, që mbetet jo i shtrejtë për të jetuar, që shkon shpejtë përpara dhe i freskët klimatik gjatë viteve me vapë që do të vijnë.

Për sot, për nesër, për Mynihun.

Sepse më shumë është e mundur.

„Unë dua që Mynihu të jetë dhe të mbetet një qytet i përballueshëm financiarisht dhe me kualitet jetësor, me mundësi për secilin dhe gjithëkënd. Si fizikant (fizicient) që jam jam mësuar ti analizoj me themel problemet. Si prefekt i dytë i qytetit të Mynihut e di ku qëndron problemi. Dhe si qytetar i këtij qyteti e shoh çdo ditë çfarë mund të bëjë më tepër. Nuk mund të pranoj që njerëzit braktisin qytetin tonë për shkak të kostos së lart të jetës, që projektet ndërtimore prolongohen me vite të tëra, apo që transporti publik është jo i besueshëm (jo i saktë). Ne mundemi më mirë – dhe më shpejtë. Si prefekt i qytetit do të marrë vendime që qytetin e Mynihut do ta çojnë përpara. Me rrespekt për atë që qytetin tonë e bënë të veçantë – dhe me guximin për ndryshmet, që neve na nevojiten. Unë nuk do të bëjë të gjitha ndryshe, por shumë gjëra më mirë: për një Mynih modern, të drejtë social, në të cilin të gjithë mund të jetojnë mirë.”

Dominik Krause është prefekt i dytë i Mynihut dhe kandidon me 8 mars 2026 për prefekt kryesor (OB) të Mynihut. Ai është fizikant me profesion dhe që nga viti 2014 është i angazhuar si këshilltar në këshillin bashkiak të qytetit. Dominiku është i lindur në Mynih dhe banon në Giesing.

Sepse mundemi të bëjmë më shumë.



**GRÜNE
MÜNCHEN**

Mynihu është një vend i mrekullueshëm për të jetuar. Mirëpo shumë gjëra me kalimin e kohës ndryshojnë: qiratë e banimit eksplodojnë, rrugët janë të ngarkuara, dhe verërat më të nxehta. Që qyteti ynë të mbetet i vlefshëm për të jetuar, ne kemi nevojë për një prefekt qyteti, që qytetin tonë do ta bëjë të aftë për të ardhmen. Që modernizon Mynihun, aty ku është e nevojshme, Që nga ndryshimi bënë përparimin (progresin). Për këtë qëndron Dominik Krause. Një vizion për të ardhmen

1 **Më shumë hapësirë jetese, më pak rritje çmimesh.**

Banimi është një çështje sociale e kohës sonë. Ne bëjmë Mynihun atraktiv dhe të përballueshëm për familjet, studentët, seniorët, për të gjithë.

- ➔ Ne do të ngrejmë **një qendër të qytetit kundër abuzimit me qiratë dhe hapësirave të pabanuara** e cila do të këshillojë të prekurit dhe do të luftoj qiraxhinjët spekulant.
- ➔ Ne do të mbështesim **ndërmarrjet banesore dhe këshillat shtëpiak** që banimi dhe qiraja të mbetën me çmime të arsyeshme afatgjata.
- ➔ Ne do të **ndërtojmë banesa me çmime të përballueshme** së bashku me München Wohnen – dhe do ti ulim afatgjatë çmimet e banimit dhe të energjisë përmes një ofensive solare dhe sanuese.
- ➔ Ne do të mbështesim banimin **për shëgërtët kualifikues dhe studentët** dhe do të mundësojmë që **hapësirat e zbrazëta dhe bytot të funksionalizohen në hapësira banimi.**
- ➔ Ne do të **thjeshtojmë proceset dhe do të ndërtojmë** aty ku është prioritar, edhe aty ku është **veç e ndërtuar – urban dhe me shumëkatësi.**

2 **Më shumë trafik, më pak frustrim.**

Mynihu është një qytet i gjallë dhe në lëvizje. Ne do të bëjmë një sistem trafiku, të besueshëm, të sigurtë dhe ambiental.

- ➔ Ne do të shpreshtojmë **taktet për metronë (U Bahn) dhe tramvajët** dhe do të startojmë me busë të rinjë ekspres për zonat periferike të qytetit.
- ➔ Ne do të **ndërtojmë U 5 deri në Freiham dhe do të planifikojmë U 9**, që Mynihu të jetë më eficient dhe më i shpejtë e më pak ngarësa trafiku.
- ➔ Ne do të **ndërtojmë rrugë të sigurt për çiklistë dhe kryqëzime**, që vozitje me çikletë të jetë e pabrengë edhe gjatë rrugës për në shkollë.
- ➔ Ne do ta bëjmë Mynihun më atraktiv për **këmbësorët** duke ndërtuar kalime dhe sheshe qëndrimi nëpër rrugica.
- ➔ Ne do të ndërtojmë **pika karikimi për E-Auto** dhe do të krijojmë hapësira për **CarSharing**, në mënyrë që të gjithë të arrijnë në cakun e dëshiruar.

3 **Më shumë pemë, më pak beton.**

Mbrojtja klimatike është kujdesi bazë për jetën. Ne e bëjmë Mynihun të gjelbërt, rrisim cilësinë jetësore – në secilin kuart të qytetit.

- ➔ Ne mbjellim më shumë pemë dhe shtojmë hapësirat gjelbëruese – për më shumë hije freskuese gjatë verës, ajër të pastër dhe kualitet më të lart jetësor.
- ➔ Ne do të ndërtojmë më shumë burime freskuese në kuartet e qytetit kundër vapës dhe shadërvane për ujë të pijshëm.
- ➔ Ne do të vazhdojmë rrugëtimin tonë për klimaneutralitet me vendosmëri – përmes sanitimit energjetik dhe rritjes së kapaciteteve solare dhe gjeotermike.
- ➔ Ne do ta bëjmë Mynihun një Zero-Waste-City me kosha të verdhë për mbeturina, kosha për mbeturinat elektrike si dhe oferta për Repaircafé dhe Foodsharing.
- ➔ Ne do të mbështesim ngritjen e kopshteve me pemë frytëdhënës, për një qytet të gjelbërt dhe „ushqyes”.

4 Më shumë përparim, më pak formularë.

Ekonomia dhe zhvillimi i qëndrueshëm ekonomik shkojnë s'bashku. Ne mbështesim inovacionin, artizanet dhe punën e ndershme – që Mynihu edhe në të ardhmen funksional dhe i aftë të mbetet.

- ➔ Ne do të krijojmë një zyrë StartAmt për ndërmarrjet/et e rinjë/e reja ku lejet e punës dhe këshillat do të bëheshin njëkohsisht.
- ➔ Ne do të ofrojmë hapësirat e lira (të zbrazta) për Start-up dhe ndërmarrjet kreative dhe artizanale.
- ➔ Ne do të ndalojmë projektet e mëdha të dëmshme klimatike, siq është autotuneli i ri dhe investimet do ti drejtojmë në infrastrukturë të pastër.

- ➔ Ne mbështesim aftësimin e metutjeshëm profesional dhe kurset gjuhësore, që të gjithë të përfitojnë nga transformimi në tregun e punës.
- ➔ Ne do të zbatojmë standarde obligative të qëndrueshme për evenimentet e mëdha.

5 Më shumë siguri, më pak telashe (shqetësime).

Siguria do të thotë kualitet jetësor. Ne e bëjmë Mynihun më të sigurt, më të pastër dhe solidar.

- ➔ Ne do ti mbushim me jetë sheshet dhe parqet përmes aktiviteteve kulturore e sportive duke krijuar ambiente të mirëqenjes.
- ➔ Ne do të mbështesim Frauen-Nacht-Taxi për të forcuar sigurinë e grave në rrugë në orët e vona.
- ➔ Ne përmisojmë ndriçimin dhe pastërtinë në stacionet e trafikut.
- ➔ Ne zgjerojmë shërbimin sanitar shkollor duke ndërmjetsuar që në fillim guximin qytetar (kurazhën civile).
- ➔ Ne sanojmë oficinën e veglave për zjarrfikësit vullnetar dhe do të mbështesim vendqëndrimin e zjarrfikësve në Giesing.

6 Më shumë ngjyra (diversitet), më pak fashistë.

Mynihu mbetet një qytet i hapur. Ne qëndrojmë konsekuent në anën e gjithë atyre që janë të rrezikuar nga nxitja e urrejtjes.

- ➔ Ne i kundërvihemi me vendosmëri ekstremizmit të djathtë – kurrfarë hapësirë publike, kurrfarë ndikimi politik, kurrfarë shtrirje të ekstremizmit të djathtë.

- ➔ Ne do të mbështesim projektet e ndërgjegjsimit në shkolla duke rritur me kohë akceptancën ndaj komunitetit LGBTQ*.
- ➔ Me ne migrantët/et do të jenë të pranishëm dhe të dukshëm në profilin e fotografisë së qytetit tonë, përmes artit, kulturës dhe bashkpunimit me organizatat e tyre.
- ➔ Ne do të forcojmë arsimimin politik nëpër qendrat rinore, shkolla dhe institucione.

7 Më shumë App, më pak pritje në radhë.

Një administratë moderne për të gjithë – më afër qytetarëve, digjital, efikase.

- ➔ Ne do të iniciojmë një Bürger*innenkonto, që mundësi që të gjitha kërkesat të shqyrtohen dhe përpunohen online.
- ➔ Ne do të përmirsojmë shërbimet për qytetarët/et ashtu që këshillimet dhe shkëmbimet me qytetarë në lagjet e tyre do të jetë një përparsi për ta.
- ➔ Ne do të mbështesim pjesmarrjen digjitale të qytetarëve duke ofruar orë konsultimi përmes Computer dhe Smartphone.
- ➔ Ne do të fillojmë me Open Source duke mundësuar një administratë të pavarur, të përgjegjshme dhe transparente.
- ➔ Ne do të modernizojmë tubimet me qytetarë/e për më shumë dialog dhe zgjidhje të problemeve duke mbështetur e forcuar këshillat bashkiak.

8 Më shumë kulturë, më pak ndarje (ndasi) shoqërore.

Kultura është zemra e qytetit tonë të larmishëm. Të gjithë qytetarët e Mynihut duhet ta

ndejnë dhe përjetojnë këtë dhe në të njëjtën kohë të bëhen vetë kreativ.

- ➔ Ne do të sigurojmë shfrytëzimin e Gasteigut duke bërë që ajo të mbetet qendra më e madhe kulturore e Europës.
- ➔ Ne mbrojmë klubet dhe skenat nga zhvendosja e tyre – me një City-Club krijojmë hapësira të reja për DJ-të dhe Kollektive.
- ➔ Ne forcojmë kulturën e kujtesës për të kaluarën dhe do të riemërojmë të gjitha rrugët e qytetit që mbajnë emra nga e kaluara nacionalsocialiste.
- ➔ Ne sjellim aktivitetet dhe takimet kulturore në të gjitha pjesët (kuartet) e qytetit dhe ato nuk duhet të jenë peng i mbështetjes financiare.

9 Më shumë mundësi, më pak kufizime.

Arsim dhe sport për të gjithë – që nga kopshti deri në shoqata. Ne kujdesemi për mundësi të barabarta dhe çasje në to.

- ➔ Ne do të krijojmë më shumë vende në kopshte dhe do të vazhdojmë me ofenzivën për trajnim profesional të personelit dhe do të thjeshtësojmë ndarjen e vendeve nëpër kopshte.
- ➔ Ne modernizojmë shkollat dhe sheshet e lojrave, mësonjëtoret me mësim kooperativ tërëditor.
- ➔ Ne do të zgjerojmë klasët fillestare për fëmijët refugjatë dhe mbështesim arritjen e njohurive gjuhësore përmes Lesestart Programm të bibliotekës së qytetit.
- ➔ Ne ndërtojmë pallate të reja të sportit dhe pishina noti-të gjithë fëmijët duhet të mësojnë notit gjatë procesit mësimor.

- ➔ Ne e kemi **zhvilluar Mynihun në Green Host City** i cili eventet e mëdha sportive i mendo dhe unstinting në mënyrë të qëndrueshme.

10 Më shumë bashkim, më pak Antagonizëm.

Një qytet për të gjithë-solidar, i drejtë,njerëzor. Ne mendojmë të gjithë së bashku.

- ➔ Ne do të aktivizojmë **Fondin Energjetik** duke ndihmuar qytetarët me të ardhura të ulëta (Münchenpass – Einkommensgrenze) për shpenzimet e energjisë elektrike.
- ➔ Ne do të **zgjerojmë programin për ndihmë administrative** (Formularhilfe-Programme) duke i përqëndruar nëpër qendra sociale.
- ➔ Ne mundësojmë **qendra banimi me çmim të volitshëm për seniorët/et** duke reformuar "Wohnen für Hilfe".
- ➔ Ne përmirsojmë kushtet e banimit për **njerëzit në qendrat strehuese.**
- ➔ Ne do të **zgjerojmë konfliktmenagjmentin gjithëpartiak** (AKIM) duke mundësuar zgjidhjen e konflikteve në mënyrë paqesore në kuartet e qytetit.

11 Më shumë kujdes, më pak vetmi.

Shëndetsia dhe kujdesi shëndetsor është një e arritur e madhe-përkujdesja jonë vlen për gjithë qytetin.

- ➔ Ne do të **zgjerojmë qendrat shëndetsore** – me më shumë pika referimi në zonat më të prekura të qytetit përmes fondeve duke krijuar "**Stadt Praxis**".
- ➔ Ne do të **digjitalizojmë proceset e përkujdesjes** duke lehtësuar barrën përsonelit përmes IA dhe robotikës.

- ➔ Ne do të krijojmë një **qendër për personat që përkujdesen për të afërmit** e tyre,për tju ndihmuar në punët e përditshme.
- ➔ Ne sigurojmë **çasje (akses) në rastet e ndërprerjes së shtatzanisë dhe mundësojmë trajnime për mjekët/et.**
- ➔ Ne ofrojmë **parandalimin e varësisë me prag të ulët** për të gjitha grupmoshat.

12 Më shumë barazi për gratë, më pak fjalë boshe.

Ne qëndrojmë (jemi) për barazi gjinore – jo në 80 vitet e ardhëshme, por sot!

- ➔ Ne angazhohemi që minimum 50% e pozitave **udhëheqëse në administratën e qytetit** të jenë të udhehequra nga gratë.
- ➔ Ne do të bëjmë shtesë më së paku edhe një **shtëpi për gra** (Frauenhaus).
- ➔ Ne do të **zgjerojmë punën parandaluese me persona të dhunshëm** përmes programit preventiv MiM dhe Stop dhunës ndërmjet partnerëve.
- ➔ Ne ofrojmë **testime falas për substancat mpirëse (K.O.) dhe artikuj menstrual** në të gjitha entet publike të qytetit.
- ➔ Ne kujdesemi për **furnizimin e vazhdueshëm gjatë shtatzanisë dhe lindjes** – inkluziv me një spital të ri për lindje (obstetrik).

Me 8 mars 2026: Votoni gjelbërt.

Mynihu mundet më shumë:për një jetë solide,të shkojmë përpara dhe për një qytet ambiental. Dominik Krause dhe të Gjelbërit – për sot,për nesër, për Mynihun.

Sepse mundemi të bëjmë më shumë.